

Në bazë të nenit 99, paragrafi 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10 dhe 17/11) dhe Rregullores për mënyrën dhe kushtet e organizimit të mësimit praktik për studentët (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 120/10), si dhe në bazë të nenit 56 të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL), Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 12.04.2011 e miratoi këtë:

REGULLORE PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E ORGANIZIMIT TË MËSIMIT PRAKTIK PËR STUDENTËT

Neni 1

Me këtë rregullore përshkruhet mënyra dhe kushtet e organizimit të mësimit praktik për studentët.

Neni 2

Në përputhje me këtë Rregullore, Universiteti i Evropës Juglindore merr përsipër që ta organizoj mësimin praktik me volum të caktuar, mënyrën e realizimit dhe kohëzgjatje, e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 ditë.

Neni 3

Fakultetet në bashkëpunim me Qendrën e karrierës dhe me personat juridik përkatës sigurojnë realizimin e mësimit praktik për studentët.

Neni 4

Gjatë realizimit të mësimit praktik studenti është nën mbikëqyrjen e mentorit nga radhët e kuadrit akademik të fakultetit përkatës.

Dekani i fakultetit përkatës e cakton numrin e studentëve, të cilët një mentor do t'i mbikëqyr për përfundimin e suksesshëm të mësimit praktik.

Neni 5

Mentori i mësimit praktik në bashkëpunim me Zyrën e dekanit gjatë dërgimit të studentit në mësimin praktik është i detyruar që të njëjtit t'i jep:

- Vërtetim për dërgim në mësim praktik, secilit student në veçanti;
- Ditarë për udhëheqjen e evidencës për aktivitetet e përditshme.

Neni 6

Mësimi klinik, do të realizohet në kuadër të programeve përkatëse të lëndëve me volum të përcaktuar me këtë Rregullore.

Realizimi i mësimit praktik realizohet në hapësirat e organizatës (institucionit), ku është dërguar studenti në bazë të pajtimit paraprak ndërmjet Universitetit dhe institucionit (organizatës) përkatës.

Gjatë realizimit të mësimit praktik studenti merr udhëzime të përditshme nga personi përgjegjës në organizatën pranuese të studentit.

Neni 7

Pas përfundimit të mësimit praktik studenti e kthen tek mentori vërtetimin e nënshkruar dhe të verifikuar, të marrë nga personi përgjegjës në organizatë (institucion), me të cilin ka qenë i dërguar për mësim praktik si dhe ditarin e plotësuar me aktivitetet e përditshme të realizuara gjatë mësimit praktik.

Mentori, pas kompletimit të të gjitha vërtetimeve të dorëzuara nga studentët, dorëzon në shërbimin studentor një listë të studentëve të cilët kanë përfunduar mësimin praktik me sukses.

Neni 8

Kjo Rregullore hynë në fuqi prej 1 shtatori 2011.